



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 06-623/16
KLINË, 30.1.2016

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
TË SEANCËS SË PARË TË KK-SË TË MBAJTUR MË 30.1.2016, NË ORËN 10.00, NË
SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i komunës, Enver Berisha, anëtarë të Kuvendit, drejtorë të drejtorive komunale, përfaq. të Policisë së Kosovës në Klinë, toger Rexhë Berisha, përfaq. të KFOR-it, Zyra ligjore, OSBE, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e kryesoi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KK- së, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi suksese Kuvendit në këtë sezon të punimeve. “Materialin e keni marrë bashkë me rendin e ditës, hapi diskutimin rreth rendit të ditës”, tha Dr. Ibishi.

Tunë Dedaj, tha se në emër të Grupit të anëtarëve të AAK-së që përfaqësoj, kërkoj që të gjejme mënyrën, ose si pikë e veçantë e rendit të ditës, apo në formë tjetër, të diskutojmë rreth disa pllakave për shpallje në qytet.

Haxhi Ibishi, theksoi se kjo çështje le të mbetet në cilësinë si pyetje, që duhet të na jap ekzekutivi.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime u miratua ky

REND I DITËS

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2016 (ref zyrt. i Prokurimit),



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 06-623/16
KLINË, 30.1.2016

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
TË SEANCËS SË PARË TË KK-SË TË MBAJTUR MË 30.1.2016, NË ORËN 10.00, NË
SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i komunës, Enver Berisha, anëtarë të Kuvendit, drejtorë të drejtorive komunale, përfaq. të Policisë së Kosovës në Klinë, toger Rexhë Berisha, përfaq. të KFOR-it, Zyra ligjore, OSBE, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e kryesoi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KK- së, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi suksese Kuvendit në këtë sezon të punimeve. “Materialin e keni marrë bashkë me rendin e ditës, hapi diskutimin rreth rendit të ditës”, tha Dr. Ibishi.

Tunë Dedaj, tha se në emër të Grupit të anëtarëve të AAK-së që përfaqësoj, kërkoj që të gjejnë mënyrën, ose si pikë e veçantë e rendit të ditës, apo në formë tjetër, të diskutojmë rreth disa pllakave për shpallje në qytet.

Haxhi Ibishi, theksoi se kjo çështje le të mbetet në cilësinë si pyetje, që duhet të na jap ekzekutivi.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime u miratua ky

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2016 (ref zyrt. i Prokurimit),

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre (ref. Zyra ligjore);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Masat Disiplinore dhe Kodin e Mirësjelljes në të gjitha Institucionet Edukativo-arsimore dhe Aftësuese në Komunën e Klinës (ref. Zyra ligjore),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015-2022 (ref. Zyrt. i MM),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës,
9. Rishqyrtimi i Vendimit për Planin Rregullues të Hollësishëm për qytetin e Klinës – për harmonizim me Ligjin për Planifikim Hapësinor, Nr. 04/L-174,
10. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit.

Pika e parë: Arsytimi i mungesave.

Në seancë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Haxhi Ibishi, sqaroi se jemi dakorduar që rekomandimet të KPF-së të miratohen në paketë. “Mirëpo, kësaj radhe pasi që kemi të bëjmë me një petition të banorëve të fshatit Poterq, bashkë me Kryetarin kemi marrë vendim që ky petition të shqyrtohet në seancën e radhës, përkatësisht të shkurtit”, shtoi Kryesuesi.

Vlora Tafilaj, tha se dola para jush për t’i prezantuar disa keqmenaxhime rreth kanalizimit të fshatit Poterq...

Haxhi Ibishi, kërkoi nga anëtarja Tafilaj pasi që kjo çështje do të debatohet për seancën e shkurtit, të mos vazhdojë me diskutim, pasi që kur në seancën e radhës kjo çështje do të jetë në rend të ditës do t’i ketë mundësitë që t’i ngreh çështjet të cilat i ka paraparë për t’i prezantuar. “Le të debatohet për seancën e radhës”, theksoi Kryesuesi Ibishi.

Anëtarja Tafilaj pati mirëkuptim rreth këtij propozimi të Kryesuesit, prandaj edhe u tërhoq nga vazhdimi i diskutimit me kërkesën që në seancën e radhës të Kuvendit (seancën e shkurtit), çështja e petitionit të banorëve të Poterqit të diskutohet.

Fadil Gashi, kërkoi që për seancën e radhës të KK-së të debatohet rreth këtij peticioni të këtyre qytetarëve.

Haxhi Ibishi, vuri në miratim rekomandimet e KPF-së.

Me 20 vota për, 5 kundër, u miratuan rekomandimet e KPF-së.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2016 (ref. Zyr. Abaz Foniqi).

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te zytari i Zyrës së prokurimit, z. Abaz Foniqi.

Abaz Foniqi (zyrtar i Zyrës së prokurimit), referoi rreth Plani të prokurimit për vitin 2016.

“Plani është bërë në kuadër të drejtorive komunale. Pjesa e dytë e mjeteve që janë miratuar në AK janë në vijimësi. Kemi tabelarët e planifikimit. Projektet kapitale e kanë vlerën e buxhetit të miratuar nga AK. Klina nga Qeveria e Kosovës ka përfituar disa projekte në vlerë prej 94200 euro. Janë projekte për të mirën e qytetarëve të Komunës së Klinës”, tha zytari Foniqi, i cili në vijim potencoi projektet e parapara për realizim). “Në Planin e Prokurimit është rregullimi i shtratit të lumit Klina. Ministria e Planifikimit hapësinor e ka dhënë të drejtën që ky projekt të realizohet me një partneritet publiko-privat, shtoi zytari Foniqi, i cili në vijim sqaroi edhe çështje të tjera që kishin të bëjnë rreth Planit të Prokurimit për vitin 2016”, sqaroi në raportimin e tij zytari Foniqi.

Tunë Dedaj, theksoi se më vjen mirë që këto para janë përfituar nga Qeveria, do të thotë me punën që ka bërë Komuna jonë, ka arritur ta merr një shumë të hollave nga ana e Qeverisë. Këto mjete me duket që kanë shkuar pa vend, nuk jam kundër ndërtimit të atyre rrugëve që lidh Zllakuqanin me Shtupelin, as ajo rruga në Kërnice, por është dashur për t’i dhënë prioritet shumë më të madh rrugës që lidhë prej Stupë deri në Zajm, se ajo rrugë e çliron edhe qytetin e Klinës. Këto mjete është dashur të orientohen në atë rrugë, se edhe Klinën e ndihmon, qytetin e ndihmon, qendrën. Ne e dimë që së shpejti kjo rrugë do të mbyllet, edhe kishte për të qenë mirë për të qenë ajo rrugë alternative që kamionët të mos vijnë këndeje”, shtoi anëtari Dedaj.

Avni Gashi, tha se më vjen mirë për këtë ndihmë prej 900 mijë euro ju kanë ndarë Komunës së Klinës. “Definitivisht te Plani i prokurimit nuk ka një përputhje me buxhetin, d.m.th. nuk korrespondojnë me buxhetin që kemi aprovuar pavarësisht që është aprovuar prej AK ne kemi pasur kundërshtimet tona qysh i kemi edhe kundërshtimet edhe për këtë plan. Tash se dimë qysh për t’u balancuar eksplorimi i rërës kur nuk e dimë saktësisht në çfarë raporti kanë eksploruar nuk mund të themi përmendsh dhe ta votojmë pa i pasur disa informata të hollësishme. Neve na ka ardhur në raport, janë vetëm thjesht shifra, është vetëm orientues, prandaj jemi edhe kundër këtij Plani të prokurimit pa marrë informata më të hollësishme”, shtoi anëtari Gashi.

Ndue Shabanaj, theksoi se shpreh kënaqësinë për këto mjete që u përmenden këtu, që i janë dedikuar Komunës së Klinës nga niveli qendror, që kemi pasur nevojë dhe janë të mirëseardhura. Çështja e orientimit të tyre për realizim të projekteve gjithmonë ka diskutime të ndryshme, gjithmonë mund të ketë prioritet mbi prioritetet ose të gjitha investimet që bëhen janë në funksion të krijimit të mirëqenies së qytetarëve dhe unë nuk kisha dashur për t'u orientuar fort në këtë seancë të AK, për këtë e drejtë ose e padrejtë investimi në një drejtim për shkak se mund të japim konstatime që nuk qëndrojnë. Kudo të investohet dhe ato investime që bëhen sipas planifikimit paraparak natyrisht se kanë edhe arsyeshmërinë më të madhe. Se ne i kemi aprovuar këto projekte me prioritet dhe ato të shkojnë drejt realizimit të projekteve të aprovuara në AK. Këto lidhur me planifikimin unë desha vetëm një vërejtje të shkurtër për të thënë për këtë formën e komunikimit tonë zyrtar me shkrim. Për bindjen time ka nevojë të përmirësojmë shumëçka në këtë drejtim kur komunikojmë me shkrim që është drejtoria përkatëse me AK, me qytetarët ose gjitha format tjera të komunikimit me shkrim duhet të jenë për bindjen time në nivel shumë më të lartë se sa që janë tash. Me të vërtetë ne kemi pasur kohëra kur nuk i kemi pasur kushtet dhe mundësitë as të korigjimit, as të shkrimit, dhe i kemi toleruar të gjitha këto, por nuk vyen për të lejuar të bëhet një praktikë i një niveli të ulët të komunikimit me shkrim, qoftë në formë zyrtare me AK, qoftë drejtoria me drejtorinë ose nivelet e ndryshme të pushtetit me nivelin qendror, edhe me qytetarët. Kemi një obligim krahas këtyre të dhënave që janë të domosdoshme të paraqiten në një raport edhe të kemi kujdes këtë çështjen e komunikimit. Nuk jam duke dashur vetëm për ta orientuar vetëm me këtë rast, por dua për të thënë për të gjitha rastet të komunikimit tonë me shkrim të përmirësohen. Dhe kjo jo vetëm të konstatohet, por unë mendoje ka ardhur momenti i fundit të shihet në praktikë një përmirësim i tillë”, nënvizoi profesor Shabanaj.

Fadil Gashi, tha se edhe në KPF i kam dhënë vërejtjet, po shihet edhe në këtë seancë, se zyrtari i Prokurimit ka të drejtë të na flasë vetëm Planin e Prokurimit, por jo për projektet as për donacionet, as për grantet, sepse ky është i thirrur për të na prezantuar këtë Plan të prokurimit për këtë vit, edhe krejt këto të tjerat i takojnë këtij Kuvendi, i takojnë miratimit në këtë Kuvend të projekteve që i bërë, që ky plan për fat të keq nuk është i harmonizuar me projektet që na i kemi miratuar vetë në këtë Kuvend. Domethënë ne këtu nuk kemi miratuar as sheqer as kafe, as çaj, me krejt respektin e di që janë të obliguar për t'i planifikuar për t'i shkruar por si duket nja 3 faqe janë për aso gjera dhe krejt një faqe e gjysme kemi këtu projekte të tjera që ne i quajmë kapitale, por si tërësi do të thotë nuk korrespondon me miratimin ose vendimin e këtij Kuvendi kur e kemi miratuar buxhetin me ato projekte dhe me ato shuma të përcaktuara. Dhe në këtë rast, e kam thënë edhe në KPF, gjatë vitit fiskal ka për të dalë ajo mospërputhje e këtij planifikimi të prokurimit dhe në fund po që se ne e kërkojmë ose kishim për ta kërkuar këtë gjë që s'po e bëjmë kurrë, raportin e punës njëvjeçare, del që ai raport nuk ka për t'u harmonizuar kurrë me këtë planifikim që është bërë. Këto janë ato që ne po i shohim, që po ka devijime prej vendimeve të vetë kësaj AK, edhe gjatë proceseve po i ndryshojnë bash ka po ju teket. Edhe këto janë shuma, janë projekte që nuk duhet kujt t'i teket pa një procedurë të mirëfilltë dhe pa u marrë vendimi këtu në këtë Kuvend. Ne tjetër gjë po votojmë në projekt-buxhet atje, tjetër gjë na

ofrohet tash për planifikim të prokurimit të projekteve krejt tjera, duke përfshirë edhe këtë pjesën e rregullimit të shtratis të Drinit dhe ju e dini aq sa është një pjesë e madhe këtu, që kjo është më shumë një lojë se sa një projekt i mirëfilltë, nëse shkohet me partneritet publiko-privat. Sepse nuk është një përvojë që po nisni ju tash, por ka pasur iniciativa dhe ka pasur këso projekte edhe në të kaluarën që veç e kanë dëmtuar shtratin, ia kanë marrë atë pjesë që ju ka nevojitur kompanive dhe asnjëherë nuk e kanë bërë atë që është dashur, sepse edhe atje ku kanë marrë që e kanë shfrytëzuar shtratin e Drinit, edhe në licenca ju shkruan që duhet për ta kthyer në gjendjen e mëparshme. Për ta dhënë shtratin e Drinit në koncesion publiko-privat s'e di uroj të keni përvojë ndokund edhe ju del mirë, se ju e dini që rregullimi i shtratis të lumit Klina qysh është bërë sa i bukur, është bërë me një investim të Komunës. Donatorit dhe është investim real dhe i prekshëm edhe që shihet. Por të jepet shtrati i Drinit me interes publiko-privat, se di ndoshta është edhe ndonjë përvojë tjetër, por unë shumë pak po i besoj", theksoi anëtari Gashi.

Skënder Merturi, tha se disa vërejtje i kam dhënë edhe në KPF. "Po dua të bëj një pyetje: te Plani i Prokurimit për vitin 2016 nuk po parashihet askund ndërtimi i sheshit, po ashtu as në Planin e Prokurimit për 2015 nuk është paraparë ndërtimi i sheshit, ndërsa ne e dimë që është nënshkruar një kontratë edhe priten shumë shpejt për t'ia filluar ndërtimit të këtij sheshi me gjithë kundërshtimet dhe mospajtimet që i kemi pasur këtu. Desha një shpjegim më në detaje për sheshin nëse kishte pasur mundësi zyrtari i prokurimit, qysh është munduar për t'u bërë kur nuk parashihet me Plan të Prokurimit për 2015, po ashtu tash edhe për 2016, se jemi në vitin 2016. Ndërsa ato që i tha Fadili janë konstatime të qëndrueshme edhe nuk mendoj që është mire që të votohet dhe të vihet një plan i tillë pa qenë më shumë në detaje, pa pasur më shumë informacione", tha anëtari Merturi.

Abaz Foniqi, tha se buxheti i miratuar në këtë AK për projektet e caktuara, ka projekte se shumë prej tyre janë të përfunduara procedurat. "Ky planifikim i prokurimit është për procedurën e re që do të fillojë më 2016. Derisa i kemi procedurat e filluara para dy viteve edhe është në vijimësi, ju keni miratuar edhe pjesën e mbetur të mjeteve që atij projekti i kanë munguar. Unë tash nuk kam të drejtë, përkatësisht mundësi ligjore ta fus edhe një herë shkollën e Këpuzit ose të Jashanicës kur procedurat janë kryer. Ky planifikim është prej 21 janarit të këtij viti që ka ndryshuar edhe ligji deri më 31 dhjetor 2016. Andaj nuk përputhet përfitimi me buxhetin. Edhe lajmin e mirë që ju kumtova nuk e thashë që unë kam për t'i bërë këto procedura që ka fituar Klina këto projekte nga Ministria e Infrastrukturës. Është praktikë se ajo ministri i ka ndarë mjetet me emërtimin që ka fituar një grant ose ka fituar një projekt Komuna e Klinës për të mirën e qytetarëve, ndërsa procedurat mund t'i kryejë edhe Ministria e Infrastrukturës. Unë kryej procedurat sipas kërkesave të njësive kërkuese dhe të departamenteve bazuar në këtë. Për sheshin, në buxhetin e vitit të kaluar ka qenë një buxhet i ndarë, rregullimi i rrugëve dhe infrastrukturës në Komunë, në Klinë, në qytet. Ju e dini që në fillim kanë qenë të buxhetuara 250 mijë euro, me rishikimin e buxhetit ajo shumë është ngritur në 400 mijë euro, dhe pas rishikimit të buxhetit kanë filluar procedurat e prokurimit me një titull pak më të modifikuar: rregullimi i sheshit dhe infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në qytet, ku janë të emërtuara edhe

rrugët. Rruga prej hekurudhës deri të sheshi “Mujë Krasniqi”, rruga prej “Nënë Terezës” deri te sheshi “Mujë Krasniqi”, dhe prej sheshit deri në hyrje të Klinës. Me këtë ka filluar edhe projekti për rregullimin e sheshit. Tash, derisa 400 mijë euro kanë qenë të buxhetuara derisa projekti ka qenë i emërtuar. Ne vitin e kaluar ka qenë ai titull. Ekzekutivi ka paraparë që ky shesh do të ndërtohet dhe do të zgjerohet. Është bërë një projekt i më detajuar, projekt zbatues, kanë filluar procedurat konform Ligjit të prokurimit publik. Ju garantoj që ky shesh i ka tejkaluar të gjitha hallkat e një shikimi, ka qenë në OSHP, është studiuar në detaje a kemi pasur të drejtë apo nuk kemi pasur, na është dhënë e drejta për po; ka qenë edhe në antikorrupsion, na është kthyer që kemi mundësi për të vazhduar me procedurën, sepse nuk janë bërë shkelje, është vlerësuar drejt nga Komisioni për vlerësim; kanë kaluar të gjitha afatet e ankesave dhe ka ardhur momenti i nënshkrimit të kontratës. Kontrata është nënshkruar sepse ju e dini se edhe ligji e ndalon se nëse nuk janë mjetet të siguruara nuk lidhet kontrata”, shtoi zyrtari Foniqi, i cili në vijim sqaroi edhe shumë çështje të tjera rreth sheshit. “Ky shesh sipas dinamikës ka për t’u kryer për 360 ditë pune, për 3 vjet është i kontraktuar”, sqaroi zyrtari Foniqi.

Fadil Gashi, tha se a ka mundësi të na sqarojë këtë projektin e shtratit të Drinit, publiko-privat që po i thonë këta, edhe i kanë planifikuar 500 mijë euro. “Derisa është publiko-privat unë nuk e di çfarë keni ju për të planifikuar. Ai merr edhe zallin edhe paratë, vetëm këtë të na sqarojë”, theksoi anëtari Gashi.

Avni Gashi, tha se ne i patën vërejtjet tona, por vetë zoti Foniqi na i kujtojë të gjitha këto parregullsi që i kanë bërë gjatë këtij tenderi, domethënë të ndërtimit të sheshit, i është ndërruar emri, i është ndërruar destinomi, është anuluar tenderi etj. Pyetja ishte: pse nuk është hyrë në Planin e Prokurimit as për vitin 2015, as për vitin 2016, ndërtimi i sheshit. Ky e vërtetoi me fjalë të veta se janë bërë njëqind shkelje procedurale komplet për ndërtimin e këtij projekti, as nuk kanë qenë mjetet, as asgjë”, pohoi anëtari Gashi.

Abaz Foniqi, sqaroi çështjet e interesuara nga anëtarët Fadil Gashi dhe Avni Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se ky debat sigurisht veç ngrit nivelin e komunikimit dhe njohjeve të problematikave. Po e them në mënyrën më të sigurtë se është bërë problem që edhe niveli qendror komunikon mirë me nivelin lokal, po ka pengesa, kur niveli lokal nuk komunikon mirë me nivelin qendror prapë pengesa. Unë Qeverinë Mustafa – Thaçi publikisht dua ta përgëzoj për këtë përkujdesje që kanë pasur në shtesë në buxhetim të Komunës së Klinës me projektet që ka planifikuar Qeveria nacionale. Janë prej 24 milionë në nivel nacional Republike Klina me rreth 1 milion, domethënë është një vlerë që duhet të respektohet prej atij granti qeveritar që ka ndarë. Prandaj, unë të përgëzoj për punën që ke bërë dhe ftoj këshilltarët të përcaktohem për mënyrën e votimit. Në sallë të pranishëm janë 27, kush është të miratohet Plani i Prokurimit për vitin 2016”, theksoi Kryesuesi.

Me 15 vota për, 12 kundër u miratua Plani i Prokurimit për vitin 2016.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre (ref. Zyra ligjore).

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti të zytari i Zyrës ligjore, z. Driton Raci.

Driton Raci (zyrtar i Zyrës ligjore), foli rreth Projekt-rregullores për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre.

“Meqenëse deri me tani Komuna e Klinës nuk ka pasur të miratuar rregulloren, e cila do të sanksiononte veprimet të cilat dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve, kolegji i zyrtarëve të integrimi evropiane me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore integruese evropiane, duke parë se shumë komuna të Republikës së Kosovës, ende nuk e kanë të miratuar Rregulloren për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre, ku është paraqitur si shqetësim tek Asociacioni i Komunave të Kosovës draftimin e një rregulloreje të tillë, ku më pastaj Asociacioni i Komunave të Kosovës ka angazhuar kolegjin e zyrtarëve ligjorë me qëllim të hartimit të një draft rregulloreje - model, për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre. Me rastin e draftimit të kësaj model rregulloreje ajo është përcjellë nga ana e Asociacionit të Komunave të Kosovës, tek Kryetari i Komunës si model, me qëllim të përshtatjes së specifikave të Komunës së Klinës dhe modifikimit të saj me qëllim të miratimit të saj nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës. Baza ligjore e kësaj projekt rregulloreje është tek Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, 03/L-040, Konventa për të Drejtat e Fëmijës e vitit 1989, Ligji për Kontrollin e Duhanit, nr.04/L-156, si dhe Statuti i Komunës së Klinës i vitit 2010. Kjo draft - rregullore ka kaluar në të gjitha procedurat ligjore, e cila është vu në diskutim publik nga ana e Kuvendit të Komunës në seancën e nëntorit 2015, si dhe është formuar komisioni profesional për plotësimin, përshtatjen dhe modifikimin e saj me specifikat e Komunës së Klinës, më pastaj është mbajtur takimi me publikun më dt.29.12.2015, ku janë marrë vërejtjet dhe propozimet e publikut, me pastaj është diskutuar në seancën e KPF-së të dt.18.01.2016, ku edhe aty janë marrë vërejtje dhe propozimet të ndryshme nga anëtarët e KPF-së, të cilat brenda mundësive ligjore janë inkorporuar, në draftin të cilin tani ju e keni në materialet e kësaj seance, ku edhe gjatë këtij shqyrtimi do të merren parasysh propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja me qëllim që kjo rregullore të jetë sa më e kompletuar dhe të gjejë zbatim praktik, e cila do të jetë në funksion të mbrojtjes së të miturve nga dukuritë negative. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë masat për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve, veprimet e ndaluara të personave fizikë, organizatave tregtare dhe shërbyese të cilat veprime dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.

Përmbajtja e Rregullores: Kjo rregullore përmban gjithsej 11 nene, meqenëse me kohë e keni pasur draftin final në materialet e kësaj seance mendoj që nuk është e nevojshme të lexohet nen për nen, por vetëm vërejtjet dhe propozimet të cilat janë përfshirë. Nga vërejtjet a marra në takimin me publikun, komisionin për draftimin e saj, si dhe KPF-ja kanë propozua që te neni 3 pika 5 të hiqet, neni 6 të hiqet për arsye se është i përsëritur edhe tek nenin 11, ndërsa tek neni 6 tek i cili është kërkon sqarim, ju njoftoj se për personat juridikë, sipas nenit 103 pika (I) të

Ligjit, Nr.2004/16, për Veprimtarit Hoteliere, gjobat e shqiptuara për kundërvajtjet e kryera sillen nga 500 deri në 2500, të cilat mbesin në dispozicion të vlerësimeve të gjykatës lidhur me peshën e veprës së kryer, e cila procedurë inicihet nga inspektori kompetent me fletëparaqitje. Ndërsa për personat fizikë përcaktohet gjoba mandatorë prej 200 €”, ka theksuar zyrtari Raci.

Violetë Zefi, tha se meqenëse kam qenë pjesë e Komisionit për të rishikuar Rregulloren për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Në fakt në pamundësi për të qenë fizikisht atë ditë kam dërguar përmes e-mailit disa komente që unë mendoj duhet për t’u ndryshuar në këtë draft-rregullore. Nuk po i potencoi të gjitha se i kam dërguar me e-mail, mirëpo nuk po i vërej këtu të ndryshuara për këtë arsye edhe mora fjalën. Unë mendoj që disa fjali ose fjalë të caktuara në këtë draft nuk duhet për të qenë pjesë e kësaj ose duhet për t’u përshtatur. Për shembull, këtu disa herë përmendet fjala “degjeneruese” ose “shfaqje degjeneruese”, ose “përmbajtje degjeneruese” etj., unë mendoj që një fjali e tillë nuk duhet të jetë pjesë e një rregulloreje ose një dokumenti zyrtar. Unë konsideroj që është e papranueshme, duhet të gjendet një fjali, p.sh. unë mendoj që duhet të jetë përmbajtje jo të përshtatshme për moshën nën 18 vjeçare ose diçka e ngjashme. Pra, këto kanë qenë disa vërejtje të mia nëse nuk i keni marrë unë mund t’ju dërgoj prapë në e-mail, por konsideroj se nuk duhet të ndryshohen se fjalët e tilla nuk duhet të jenë pjesë e një rregulloreje të tilla për shkak se konsideroj që kjo rregullore është jashtëzakonisht e rëndësishme për këtë moshë, domethënë për të miturit të Komunës së Klinës”, shtoi anëtarja Zefi.

Haxhi Ibishi, tha se jam i bindur që ai kualifikim juaji që e bëtë është krejtësisht profesional. “Njerëzit e ligjit dhe të gjuhës që merren me çështjen e terminologjisë le ta shikojnë, kualifikimi juaji është i saktë. Ky është mendimi im për fjalën që është përdorur në këtë rregullore. Në KPF ia kemi dhënë “izën” kësaj pune vërejtja e këshilltares Zefi në aspektin profesional qëndron. Në KPF jemi pajtuar që të inkorporohen këto ndryshime që unë e pashë që Zyra Ligjore i ka inkorporuar me komisionin. Kjo rregullore i ka kaluar krejt ato portat deri këtu në vendimarrje”, tha Dr. Ibishi.

Kryesuesi me vërejtjet e këshilltares Zefi projekt-rregulloren e vuri në miratim.

Me vota unanime (27), u miratua Projekt-rregullorja për Mbrojtjen e të Miturve nga Dukuritë që Dëmtojnë Shëndetin dhe Zhvillimin e tyre.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Masat Disiplinore dhe Kodin e Mirësjelljes në të gjitha Institucionet Edukativo-arsimore dhe Aftësuese në Komunën e Klinës (ref. Zyra ligjore).

Haxhi Ibishi, foli rreth pikës së rendit të ditës. Fjalën ia dha për referim Zyrës ligjore, përkatësisht zyrtarit të lartë ligjor, z. Ali Shala.

Ali Shala (zyrtar i lartë i Zyrës Ligjore), referoi rreth projekt-rregullores. “Si çdo akt tjetër nënligjor juridik, edhe kjo projekt-rregullore ka kaluar të gjitha instancat e shqyrtimit paraprak, si nga ana e komisionit, pastaj marrjes së mendimeve prej përfaqësuesve të shkollave, Zyra Ligjore, po ashtu dhe ndihmës dhe përkrahjes që kemi pasur nga DKA-ja, duke filluar prej iniciativës që ka marrë DKA për hartimin e miratimit të kësaj rregulloreje. Komuna e Klinës një rregullore të këtillë të ngjashme e ka pasur qysh nga viti 2006, mirëpo ajo rregullativë siç e keni pasur si sqarim edhe në KPF dhe forumet tjera, nuk ka përfshirë masat disiplinore dhe kodin e mirësjelljes dhe etikës së personelit tjetër në të gjitha nivelet e arsimit shkollor në territorin e Komunës së Klinës, por ka qenë e dedikuar vetëm për nxënësit. Kështu që, meqenëse teksti i kësaj projekt-rregullore tash përfshin me një përqindje përmbajtjesore dhe shumë themelore edhe personelin tjetër, domethënë nivelin profesional arsimor dhe personelin tjetër teknik dhe administrativ, ka qenë dashur që t’i hyhet përgatitjes së një projekt-rregulloreje të re si tërësi. Edhe kjo rregullativë duke filluar prej iniciativës 16.10.2015, ka kaluar procedurat, vuarjes në diskutim publik, takimi me publikun, më 29.12.2015, KPF-së, më 18.1.2016, draftit të tretë që kemi hartuar me DKA-në së bashku dhe si Zyrë ligjore, kemi arritur deri . draftin e katërt i cili është material i kësaj seance të AK-së. Zyra ligjore së bashku me DKA-në ka bërë përpjekjet maksimale që në kuadër të këtij teksti të inkorporohen të gjitha dispozitat pozitive, sepse në ndërkohë është ndryshuar edhe ligji sistemor i nivelit arsimor po ashtu ka pasur edhe një udhëzim i vitit 2014 i cili në mënyrë përmbajtjesore është munduar që të thjeshtësojë dhe të sqarojë materialin dhe zbatimin praktik të këtyre dy ligjeve të arsimit, si dy ligje sistemore në nivel të shtetit. Ne seancën e KPF-së, po ashtu edhe nga takimi me publikun, ne i kemi pasur parasysh vërejtjet përkatëse, mirëpo në seancën e KPF-së si forum më i ngushtë kemi pasur vërejtje dhe sugjerime shumë përmbajtjesore të cilat ka qenë dashur që të ndryshohen, të plotësohen dhe të përfshihen në dispozitat të këtij drafti të katërt të kësaj rregulloreje. Nuk jam i mendimit që të shkojmë në pako të diskutimit të kësaj rregulloreje, sepse kemi të bëjmë me çështje të rëndësishme. Është një fat i mirë që këtu kemi përfaqësues të shkollave të cilët janë drejtpërdrejtë të implikuar në sistemin e arsimit dhe vërejtjet e sugjerimet e tyre praktike duke i pasur parasysh edhe rregulloren e mëparshme 2006 mund me qenë një kontribut shumë meritues për ta bërë modifikimin dhe spastrimin eventuale të dispozitave të kësaj rregullore. Në KPF ka pasur vërejtje shumë përmbajtjesore të cilat ka qenë dashur që të merren parasysh dhe të cilat sot do t’i shqyrtojmë bashkërisht në mënyrë që këto të jenë në mënyrë definitive të përfshira në tekstin i cili do të miratohet”, shtoi zyrtari Shala, i cili në vijim sqaroi shumë çështje rreth projekt-rregullores në fjalë.”Në pjesën themelore të dispozitave ligjore janë të ndara obligimet, të drejtat, detyrat, si për personelin arsimor, atë teknik dhe ndihmës, po ashtu edhe për nxënësit i keni të kategorizuara. Obligimet e mësimdhënësve, edhe në KPF, edhe takimin me publikun është dhënë vërejtje te pika 1.5, të nenit 7, kur është fjala të respektimi i kodit të veshjes, pamjes, konform kodit të mirësjelljes, ku ndalohen, thuhet: gjinacet, fundet mbi gju, bluzat të zbuluara, pantallonat të shkurtër tek meshkujt, mjekrat e çrregullta, kjo ka qenë me theks të veçantë si

vërejtje, edhe veshjet tjera me karakter fetar. Në kuadër të kësaj pike të kësaj dispozite është mirë që së paku përkufizimi “mjekrat e çrregullta” të definohet nga ana e AK, sepse edhe atëherë e kemi thënë se është bukur zor praktikisht për ta definuar dhe për të kontribuar se çfarë është “mjekra e rregullt” dhe çka “mjekër e çrregullt”. Në këtë kuptim është mirë që propozimi i Zyrës Ligjore që në këtë aspekt të bëhet ndalimi i lëshimit të mjekrës në përgjithësi. Dihet prej cilës moshë të nivelit arsimor nxënësit mund të lëshojnë mjekër, edhe për stafin arsimor. Prapë është vendimi juaji, janë gishtat e juaj të votave, të cilët ë definojnë këtë çështje. Unë kisha pasur propozim që të shkojmë menjëherë në korrigjim të po ose jo të këtij korrigjimi, edhe në debat interaktiv, në mënyrë që koha të mos jetë krejt e imja por le të jetë edhe e asamblistëve”, ka konstatuar zyrtari Shala.

Fadil Gashi, tha se ne në KPF jemi dakorduar që të na vijë teksti i spastruar dhe tash humbim 2 orë, edhe tash s’po kemi mundësi, nen për nen po që se i hymë, domethënë nuk paskemi pasur nevojë për ta humbur atë kohë në KPF. Vërejtjet po i thotë edhe zyrtari që kanë qenë të qarta, por po shoh qysh keni marrë obligim dhe i pranuat ato vërejtje teksti nuk është prekur fare. Sikur të ishte prekur ose të na kishte ardhur një letër e veçantë dhe të ishte thënë, këtu kanë qenë propozimet për ndryshimet, ky është drafti, ai i inkorpojmë këto, ne në bllok kishim shkuar me po, mirëpo tash po duhet pikë për pikë dhe presje për presje”, tha anëtari Gashi.

Ali Shala, tha a vendos ky përkufizim kështu apo jo, është çështje e votave tuaja, me qëllim kjo është lënë. “Jo që të biem para aktit të kryer, sepse edhe ne si ZL nuk i kemi pasur atë ditë krejt të konsultuar krejt materien ligjore dhe të themi kjo fjali mbetet dhe u krye dhe ka për të qenë ky tekst. Por, kur e kemi konsultuar ligjin kemi ardhur të përfundimi prapë ju duhet për ta vendosur këtë punë., jo ZL. Këtu duhet të jemi të qartë. Prandaj, nuk na merr asgjë kohë këtu për të debatuar në mënyrë të shkurtër, interaktive dhe menjëherë votimi. Unë e dhashë propozimin dhe mendoj që e sqarova, domethënë “ndalohet lëshimi i mjekrës”, jo të “rregullta apo të “çrregullta”. Kështu domethënë jemi në frekuenca të sqaruara” shtoi zyrtari Shala.

Haxhi Ibishi, tha se me Ndoun, Halilin, Skënderin, Palin dhe të tjerë, jemi marrë vesh që krejt vërejtjet që kanë ardhur nga diskutimi publik, prek Komisionit të arsimit, prej Zyrës Ligjore, për t’u inkorporuar në projekt-rregullore nga ZL, mirëpo prapë Kuvendi është ai që thotë fjalën e fundit.” Por, unë mendoj që kanë qenë 3-4 çështje që janë ngritur nga prof. Ndou, Halilit, prej kolegëve të tjerë, është dashur të merret një përgjigje, një version të propozimit zyrtar sot, edhe ne për të proceduar. Se kështu nen për nen, realisht ne forma tjera nuk kemi, unë si kryesues me duhet respektuar në fund të fundit mendimin tuaj, të shkojmë nen për nen, secilën etapë për vendimmarrje”, pohoi Kryesuesi.

Ali Shala, tha se e vetmja fjali është kjo që e kemi debatuar, kur të hymë në tekstin e mëtutjeshëm keni për ta vërejtur se të tjerat janë të spastruara. “Me qëllim e thashë këtë të vetmen, të tjerat krejt i keni në tekst”, tha zyrtari Shala.

Arben Limani, tha se këtu fillimisht te emërtimi i rregullores, drejtori i DKA-së është edhe gjuhëtar, besoj edhe prej Zyrës Ligjore një sqarim ose një sugjerim rreth emërtimit: Rregullore Unike Shkollore për Masat Disiplinore dhe Kodin e Mirësjelljes në të gjitha Institucionet. “Unë besoj që nuk është e nevojshme, por këtë për ta shkurtuar “për institucionet edukativo-arsimore”, se këtu po thuhet edhe “unike” edhe “në të gjitha institucionet”, besoj që më duket e tepërt. Domethënë propozimi im është që ky emërtim të ndryshohet, ndoshta edhe në mos është ndonjë gabim teknik, nëse është marrë model prej ndonjë institucione apo komune është tjetër gjë. Te obligimet e mësimdhënësve, te neni 7, këtë sqarim mendoj që mund të na jep edhe drejtori, i DKA-së, ku thuhet se “obligohet mbajtja e orëve të kujdestarisë nëpër shkolla”. Edhe menjëherë 1.17, ku thuhet: “T’u ndalohet arsimtarëve mbajtja e kurseve për nxënës të vet”. Te orët e kujdestarisë desha të pyes a paguhen tash orët e kujdestarisë, a është planifikuar pagesa e këtyre orëve, sepse pagesa e këtyre orëve nënkupton shtim të numrit të orëve mësimore, edhe kjo normalisht se nëse nuk paguhen kjo ndikon në planifikimin vjetor të secilit mësimdhënës, domethënë nëse hyn në kuadër të orëve mësimore që i ka kujdestari i klasës. Ndërsa kjo e dyta, që thashë për kurset, është një dukuri pothuaj shqetësuese unë kam dëgjuar se profesorët edhe kushtëzojnë shkuarjen në kurs ndoshta me notim të favorshëm për nxënës, fatkeqësisht kjo po na shoqëron gjatë gjithë kohës edhe do të jetë problem edhe pse ne e kalojmë ndoshta sot, do të jetë problem për t’u mbajtur. Te neni 12, “mbajtja e armëve të ftohta e të zjarrta”, këto kanë qenë të përkufizuara edhe në rregulloren e mëhershme, por edhe në rregulloret e brendshme të shkollave, por është një dukuri që po na shoqëron tash fatkeqësisht edhe këto dukuri po shfaqen në shkollat tona, bile krejt vonë një rast ka qenë në njërën nga shkollat tona, d.m.th. janë hasur armë të zjarrit edhe asnjë masë ndëshkuese ndaj atij nxënësi nuk e kanë marrë drejtorja përkatëse. Thashë, implementimi do të jetë shumë problem se nuk është që nuk kanë ekzistuar këto masa ndëshkuese ndaj nxënësve. Te lëshimi i mjekrave tash këtu po përmendet në 3-4 vende lëshimi i mjekrave të çrregullta, diku është bartja, nuk e di a është shikuar ndonjë rregullore e ndonjë vendi përfundimor, sepse lëshimi i flokëve të gjata të nxënësit mund të jetë edhe shkelje e të drejtave të fëmijës, për t’ua kufizuar bartjen e flokëve, të gjata apo të shkurtra, nuk është ushtri për të pasur rregull strikte. Po them nuk di nëse është konsultuar ndonjë rregullore e ndonjë vendi përfundimor të përparuar, sepse trajnime kryesisht në arsim i mbajnë edhe organizatat e huaja që ndihmojnë edhe në hartim të këtyre rregulloreve në të shumtën e rasteve, domethënë vetëm a kërkohet nga komuna. Mua më duket së është shkelje e të drejtave të fëmijëve të miturve të përkufizohet qysh ai i mban flokët. Te mjekra ndoshta dallon pak se aty qysh është përdorur shprehja “të çrregullta” nënkupton ndoshta për të qenë mjekra të mëdha, apo për të mos mbajtur fare. Neni 14, te pikat, 1.15, 1.16, mos kanë rrëshqitur prej ndonjë rregulloreje tjetër, apo çfarë ka ndodhur. Të na sqaroni për këto. Mbajtja e kurseve përsëritet shpeshherë, edhe te grimoja e nxënësve domethënë, neni 18, unë kujtoj që edhe kjo nuk është në përputhje me të drejtat e të miturve, të gjithë janë të mitur deri në moshën 18 vjeç. Krejt lidhur me këto çka i propozuam dhe i sugjeruam ne si grup jemi që kjo rregullore të kalojë me propozimet tjera që mund të dalin, por problemi qëndron krejt te gatishmëria e institucioneve për implementim. Unë e thashë, rasti i armëmbajtjes pa leje edhe i dhunës nëpër shkolla, ku po rrezikohen edhe nxënës tjerë, kur barten

armë, edhe mosmarrja e asnjë mase domethënë kjo shkakton edhe pasiguri edhe te nxënësit edhe te besimi që mund të ketë përkrahje e një rregulloreje e tillë”, theksoi anëtari Limani.

Tunë Dedaj, tha se po flas në emër të grupit, së pari më vjen mirë që kjo rregullore unike po bëhet për herë të parë në Klinë dhe është shumë e mirë dhe shumë e qëlluar. “Desha të them se u potencuan armët, policia vepron dhe se kur t’ua zënë ua marrin, nuk ka pasur nevojë të vihet kod këtu, se është e ndaluar kudo,. Mendimi im për mjekrat është mirë që të mos lejohen as te nxënësit, as te arsimtarët, As nxënësi të shkojë me mjekër, as arsimtari të mos shkojë me mjekër. Te dhënia e kurseve, që i bëjnë profesorët jashtë orarit mësimor, është mirë ato kurse të mbahen, por të mos kenë të drejtë t’i marrin nxënësit e tyre. Nuk është mirë të ndalohet mbajtja e kurseve, por të mos i marrin nxënësit e tyre. Edhe shamitë të mos barten, edhe bartja e pantallonave të shkurtër të mos lejohet, as arsimtarit as nxënësit, sepse shqiptarit nuk i ka hije bartja e pantallonave të shkurtër as të mjekrave”, shtoi anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, tha se secili ka të drejtën e diskutimit, nëse ka konkrete propozime është mirë për t’u koncentruar në nenin konkret secili çka mendon me ndryshuar ose ka propozim konkret. “Diskutim i yt ishte në frymën e një rasti ose dy rasteve ose 2-3 çështjeve që janë të ngritura edhe çështja e dukjes, edhe e mjekrës, është një qëndrim që edhe KPF ka mbajtur një qëndrim rreth këtyre dukurive”, shtoi Kryesuesi.

Ndue Shabanaj, tha se më vërejtjet që i kemi dhënë në KPF dhe që kemi llogaritur se vërejtjet që i kemi dhënë të merren për bazë dhe të përfshihen në këtë projekt-rregullore që do të vjen për miratim në këtë seancë të AK. Kjo nuk ka ndodhur, është çështje që ne i kemi pritur. Ka edhe vërejtje tjera që ne i kemi dhënë në KPF dhe realisht kanë arsye të jepen edhe sot në këtë seancë. Dëshirojmë për ta pranuar angazhimin dhe punën e komisionit që kanë punuar në hartimin e kësaj rregulloreje unike, por për bindjen time ka nevojë për ndryshime shumë të mëdha. Më së pari rregullorja ka përsëritje të panevojshme në shumë pjesë të saj. Dhe nëse eliminohen këto përsëritje kjo e merr formën shumë më të mirë se sa që është sot. Është aq voluminoze sa realisht hyn në siklet njeriu për ta lexuar këtë, lërë për ta zbatuar gjithnjë e më shumë, për çdo ditë e më vështirë. Unë kisha dashur dhe shpreh mendimin tim në emërtimin. Mendoj se duhet të jetë emërtimi: Rregullore unike shkollore për kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore. E jo masat disiplinore para kodit të mirësjelljes. Thjeshte në çdo pjesë, çdo nen, dhe pika të veçanta në shumicën prej tyre, kanë nevojë të riformulohen, të përcaktohen më saktë ose të eliminohen disa prej tyre që janë të përsëritura. Dhe përgjithësisht e them të gjitha ato me detyra, obligime, të drejta që lidhen me personelin arsimor nga drejtori deri te punëtori teknik, e që janë të përshkruara me detyrat dhe obligimet nga vendi i punës nuk ka nevojë të përfshihen në rregullore se ato janë të përfshira në detyrat e vendit të punës që përcaktohet me li që është i obliguar secili punëtor t’i respektojë ato. Nga kjo rregullore unë i kam nxjerrë rastet më ekstreme që ishte dashur të përmirësohen. Te neni 5, pika 1.7, ose 1.8, ndalohen grupacionet, çfarë grupacionesh janë ato? Mendoj që duhet të precizohet kjo. “Ndalohen grupacionet për qëllime destruktive”. Kjo është shumë e papërcaktuar. “Regjistrimi i nxënësve jashtë zonës së mbulimit të caktuar nga Komuna”. Kjo është çështje që kemi përcaktuar disa herë këtu, ajo edhe është e përcaktuar edhe

me vendim të AK, ndarja e zonave, veç e kemi përcaktuar kot se nuk është respektuar. Uroj të respektohet! 1.14, dëmtimi i inventarit edhe mjeteve të shkollës me veprime të ndryshme. Kjo “me veprime të ndryshme”, nuk ka nevojë për të ekzistuar fare. “Dëmtimi i inventarit dhe mjeteve të shkollës”, ishte dashur t’i shtohet: “Dëmtimi i qëllimshëm i inventarit shkollor”. Te neni 6, 1.13, (lexoi nenin), është komplikuar për bindjen time “armët e ftohta dhe përdorimi i narkotikëve...”, mendoj këtu duhet të ndryshohet. “Në raste të dyshimit të bazuar të kontrollojë nxënësit për armëmbajtje dhe posedim të lëndës narkotike”. Kjo çështja e pamjes e dukjes ka nevojë të ndryshohet dhe të harmonizohet konform të drejtave dhe të mos shkelim të drejtat e fëmijëve, të miturve me vendime tona, me masa të tilla disiplinore. Neni 1.6. (lexoi nenin), nuk ka nevojë “njerëzit me të cilët punon”, por “të personelit të shkollës përgjithësisht”, pastaj “Të sillemi me drejtësi”, “të sillemi me korrektësi”, do të ishte pak më i pranueshëm. Te pika 1.14, neni 7 dhe 1.15. (lexon nenet), mendoj që janë zgjatur pa nevojë. “Në rast se duhet lirohet nxënësi lëshohet arsyetimi me shkrim nga mësimdhënësi”. Lidhur me mbajtjen e kurseve nga nxënësit e vet, këtu nuk ishte dashur të ketë vlerësime paushalli që në një formë denigrojnë punëtorët e arsimit në masë ose përgjithësi, aty ku ka raste të veçanta dhe mund të jetë bartës i këtyre dukurive personi ose punëtori i veçantë i arsimit atëherë të adresohet problemi aty ku ekziston. Pajtohem plotësisht mos me u mbajtur kurset për nxënësit që u japin mësim. Për mua kjo është rreptësisht e ndaluar, nëse punëtori i arsimit mund të arrijë në kurset private me aftësuar nxënësin, pse nuk mundet në shkollë?! Pse nuk mundet në orën e rregullt? Aq me keq me u bërë për t’u kushtëzuar. Kushtëzimi në kurs me notën, gjë që nuk përjashtohet as kjo. “Ndalohej marrja e mitos”, po kjo është me ligje e precizuar, çka ka nevojë për të ardhur në rregullore. Neni 8 (lexoi nenin), punëtorët kanë orarin e caktuar, duhet të precizohet kjo. “Secili punëtor administrativ dhe ndihmës gjatë orarit të punës nuk duhet të largohet nga vendi i punës pa leje”. Neni 10, pika 1.3, (lexoi nenin), nuk është të respektohet dinjiteti, por t’u respektohet dinjiteti i tyre, është fjala nga personeli arsimor dhe drejtori i shkollës. Edhe “të dëgjojnë dhe të jenë të dëgjueshëm”, është aq e përgjithësuar, aq e njohur dhe e ditur, sa nuk ka nevojë të përfshihet askund. Neni 11, (lexoi nenin), “ta respektojnë kodin e mirësjelljes”. “Të keni paraqitje të jashtme të rregullt dhe të pastër”. Kjo “paraqitje”, është “dukej” më mirë është “dukje” se sa “paraqitje”, nëse bash duhet të jetë kjo. Dhe e njëjta bien ndesh, kjo ishte 1.4, neni 11, është e njëjtë “të mbajnë uniformën e shkollës gjatë procesit mësimor dhe praktikës. “të vinë në shkollë ta pajisur me tekste, fletore dhe mjete tjera të domosdoshme për orë mësimore”, domethënë nuk ka nevojë për t’u thënë gjitha këto. “Të vijnë në shkollë të përgatitur për procesin mësimor”, që nënkupton, fletoren, librin dhe gjitha. Deri në fq. 12 unë mendoj ka nevojë të analizohet secila pikë, secili nen dhe të shkurtrohet çka është e mundur. Fq, 12 dhe tutje, prej masave ndëshkuese këto kanë qenë edhe më herët dhe janë shumë më mirë të formuluar, shumë më mirë të precizuara, shumë më pak ka nevojë të ndërhyhet, nëse ka nevojë të ndërhyhet janë raste të rralla. Kam edhe një kërkesë: ne po shqyrtojmë dhe po miratojmë rregullore, por nuk po marrim variantin definitiv pas aprovimit me ndryshime, në mënyrë që t’i verifikojmë edhe ato a janë përfshirë apo jo ndryshimet me të cilat është miratuar një rregullore e caktuar”, konstatoi profesor Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se po vërej që në krejt rregulloren në përmbajtje, në substancë po ka lëshime, prandaj është mirë që ekzekutivi me u deklaruar bashkë me ZL se mos jemi në një fazë që kjo rregullore por edhe pse ka kaluar shumë stade ose pore të domosdoshme drejt miratimit, me u rikthye edhe një herë në përpunim nga njerëz profesionist. Kemi dy varianti, të shkojmë në shqyrtim dhe votim në secilin nen, ose ta kthejmë në rishqyrtim ose ripërpilim me vërejtjet dhe diskutimet tona edhe të debateve të mëhershme për seancën e shkurtit”, pohoi Kryesuesi.

Pal Berisha, po e përsëris një vërejtje time që kam dhënë në KPF, kam thënë se kësaj rregulloreje i mungon një nen veçantë dhe kam sugjeruar që ajo të bëhet në të cilën thuhet: “Duhet të shkruhet organi komunal i cili është përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje, pra në këtë rast DKA-a. Pse e kam thënë këtë? Kemi shumë kategori të përgjithshme të cilat nëse u lihen në dorë drejtorëve të interpretojnë dhe të zbatohen atëherë kemi për të krijuar konfuzitet. Unë mendova, aludova në KPF, po e përsërisë, se këto të drejta, pasi është rregullorja komunale e arsimit duhet t’i jepen DKA-së, dhe ajo t’i interpretojë dhe t’i zbatojë, si çështje, “mjekrat e çrregullta”, “flokët e gjata”, “veshje provokuese” etj. Nuk bën që secili drejtor në mënyrën e vet t’i interpretojë këto kategori. D.m.th. këtu neni 40 për mua krijon paqartësi (lexoi nenin). Unë mendoj që do të ishte shumë më me vend të shkruhet se DKA ka përgjegjësi për zbatim dhe interpretim të kësaj rregulloreje. Fjalja e fundit e nenin 40 (lexon fjalinë), nuk është e shkruar ndaj kujt merren masat disiplinore. Udhëheqësi i GP të AAK-së u deklarua kundër mjekrave, mendoj se është gabim shumë i madh, sepse mbajtja e mjekrës është e drejtë e secilit njeri dhe dëshirë e secilit njeri. Për kurset private, unë mendoj që secili mësimdhënës i cili mban kurse private duhet ta ketë obligim që ta informojë me shkrim për të gjitha detajet DKA-në, sepse DKA duhet të ketë informatë në secilën kohë për secilin mësimdhënës me të cilët ka kontratë që punojnë në shkolla, dhe mban edhe kurse private. Nuk po them që duhet të ketë implikime buxhetore por vetëm po them që DKA për secilën kohë për secilin mësimdhënës të ketë informata”, ka konstatuar anëtarë Berisha.

Halil Desku, tha se kontributin tim maksimal e kam dhënë në KPF, jo vetëm unë, por edhe të tjerët. “Kam pritur që mbledhja e KPF-së ka për të na lehtësuar më shumë se 50 për qind, mirëpo këtu po shoh se nuk na ka lehtësuar asgjë por na i ka vështirësuar edhe më shumë rrethanat. Ne të gjitha pikat e nxehta, apo diskutabile i kemi rregulluar dhe unë kam menduar që për ato nuk kemi për të pasur nevojë për të diskutuar, sepse përfaqësues të subjekteve kanë qenë në KPF dhe secili kemi pasur për obligim për t’ju shpjeguar anëtarëve tanë para kësaj mbledhje dhe t’ju themi se këto janë të kryera. Te çështja se Ndou ka të drejtë kur thotë, edhe Kryesuesi po ashtu u shpreh, se është mirë kjo rregullore për t’u shtyrë. Unë nuk jam për ta shtyrë këtë rregullore, sepse unë mendoj që edhe sot kur ta miratojmë është e vonë, se kishte për të qenë shumë më mirë e miratuar, e prej 1 shtatorit të këtij viti të fillojë së zbatuari. Domethënë është vonë. Nëse duhet për t’u shtyrë faj kam unë pse duhet për t’u shtyrë, kanë edhe të tjerët këtu që punojmë në arsim. Ishte dashur që së paku nga një i subjekteve dhe për t’i ndihmuar Për një arsye, se ne i njohim rrethanat në arsim, edhe me këto punë të gjithë jemi punëtorë shumëvjeçar që ballafaqohemi me këto probleme. Prandaj na më së miri kishim pasur mundësi të ndihmojmë Aliun. Ne nuk kemi

qenë në këto komisione dhe tash i gjejmë të metat e kësaj rregulloreje. Në kam i vedencuar shumë pika. Kjo rregullore i ka disa të meta, ne e dimë, mirëpo nuk guxojmë pa e miratuar. Çfarë mund të bëjmë sot, për t'i rregulluar pikat kyç të rregullores, që na sjellin probleme gjithmonë në arsim. Çështje tjera më të vogla, edhe nëse nuk kemi mundësim për t'i përfshirë, ne mund të ndërhyrë edhe në vitet e ardhshme në rregullore për të ndryshuar diçka. Po i potencoi disa nga pikat që parafolësit e mi nuk i kanë përmendur: te neni 7, nuk dua të flas rreth veshjet që edhe në KPF e kemi dhënë versionin tonë qysh duhet për të qenë kjo pika 1.5. Nuk dua të jap më ide sepse e kemi formuluar shumë mirë. Këtë duhet formuluar shumë mirë dhe të kemi një version final të rregullores ashtu qysh i kemi dhënë propozimet në KPF. "Pikën, 1.12, se ka përmendur askush deri më sot, këtë mund ta potencojmë në që punojmë në arsim. Te neni 7, pika 12 (lexoi nenin), kjo është diçka klasike që është punuar më herët. Tash të gjithë e dimë që mësimdhënësi duhet për t'i poseduar gjatë mësimin të gjitha planifikimet dhe planin vjetor të punës. Këto janë rregulla që duhet pasur çdo mësimdhënësi në orë gjatë punës, e tjetër çka është. Librin askush nuk mund t'ia ndalojë për ta përdorur, ndonjë fletore, ndonjë revistë shkencore, lap - topin etj. Ky formulim është shumë klasik, i paraluftës kur është dashur mësuesi të shkojë me një fletore, kjo është katastrofike. Pika 1.14 (lexoi pikën), në kllapa është paraparë niveli i parë edhe i dytë; unë kisha qitur edhe nivelin e tretë vetëm nëse vije ndesh me UA. Pika 1.15, pse mësimdhënësi nuk duhet lëshuar nxënësin prej orës mësimore. Duhet lëshuar nxënësin sepse ka nxënës më probleme, me nevoja, prandaj, duhet precizuar kush duhet për ta lëshuar. Çdo nxënës ka kujdestar klase, prandaj ai duhet të merret me të, edhe drejtori i shkollës. Pika e 14, kurset, duhet precizuar shumë mirë, për ta shkruar shumë mirë aty se pa kurse nuk bën. Kurs duhet për të mbajtur mësimdhënësi i licencuar nga shteti që paguan tatimin e shtetit, që ka licencë për atë punë, edhe i përgjigjet shtetit. Pa kurs nuk bën. Le të formulohet që me nxënës të tij dhe për t'i kushtëzuar nuk duhet. Por kurset të menaxhuara nga shteti duhet të jenë. Neni 19, pika 1.6, (lexoi nenin), është shumë e padrejtë për të qenë kjo protestë ndaj mësimdhënësve. Mësimdhënësit qenkan ata që të protestojnë nxënësit ndaj tyre a?! Unë jam për ta bërë një formulim të ri, ndryshe, dhe kam idenë qysh. Nuk thuhet "protestë ndaj mësimdhënësve", tamam po që se vjen çështja e organizimit edhe të ndonjë proteste ndaj mësimdhënësve. Orët e kujdestarisë, e kam potencuar edhe në KPF, a bëhet fjalë për orën e 20 apo të 21, orë me pagesë ose pa pagesë, sepse mësimdhënësi ka 20 orë mësimdhënie, i ka edhe 20 tjera parapërgatitje që do të thotë 40 orë. Këtë a duhet të jetë e 20-ta apo 21 –ta përgjigjen le ta jap drejtori i DKA-së. Orët e kujdestarisë janë të nevojshme të mbahen, se aty ku ka orë të kujdestarive problemet janë më të pakta", theksoi profesor Desku.

Haxhi Ibishi, kërkoi që të respektohet koha. "Ky debat flet për seriozitetin, për rëndësinë e kësaj rregulloreje. Unë ju ftoj që në hartimin e rregulloreve të kësaj në veçanti konsensusi ynë duhet për të qenë maksimal. Fëmijët tanë i kemi aty, nuk i kemi të ngjyrosur politikisht, ata janë në edukim shkollor, edhe ne duhet për t'i shtjerë të gjitha mundësitë, po që se është nevoja një herë, tri herë, pesë herë me e kthye një rregullore e cila vjen në funksion më mirë, më vonë, edhe më efikase. Këto janë qëndrime profesionale, siç i kanë e profesioneve gjegjëse, si profesori Ndue dhe profesori Halil", shtoi Kryesuesi.

Rasim Millaku, tha se fillimisht do të jemi autokritikë gjithë ne, po them prej vetes time. “Nuk kemi punuar në këtë rregullore dhe krejt çfarë është punuar shihet që ka punuar Zyra Ligjore, mirë ose keq, ka shumëçka qitet këtu dhe duhet respektuar unë. Jam për ta shtyrë dhe të punojmë nëse duam një rregullore kualitative, jo vetëm veç për ta shtyrë dhe të bëjmë vërejtje. Kisha dashur për ta kyçur dashamirësisht profesor Ndoun për shkak të kontributit të tij që mund të jap t’i kyçet kësaj rregulloreje, atje ku duhet ta nxjerrim një rregullore të mirë. Nuk jam për ta miratuar sot, por mbi të gjitha dhe në fund thërras, vetë jam punëtor i arsimit, dhe shumë lehtë e kemi ne për ta disiplinuar pjesën e nxënësve, sepse i kemi disa masa në dorë, kush më pak, kush më shumë, mirëpo disiplinimin tonë mirë është për ta filluar nga vetja. Nisma është e mirë për ta përmirësuar, por jo në këtë mënyrë. Nuk kemi punuar asnjë gjë për të përmirësuar dhe në fund për t’u respektuar kjo rregullore. Theks të veçantë kam te kurset që u përmenden këtu, ato kurse nëse nuk jemi në gjendje për t’i disiplinuar mos t’i qesim fare në pikë. Propozoj që të shtyhet kjo rregullore dhe të punohet ashtu qysh edhe e meriton, sepse edhe për atë punë e kemi sjellë këtu”, pohoi anëtari Millaku.

Enver Gashi, tha se u përmenden shumë vërejtje, mirëpo unë do të ndalëm vetëm në një vërejtje, te neni 11, pika 1.1, (lexoi nenin). Unë mendoj që është mirë që të jetë kjo projekt-rregullore e njëjtë për të gjitha shkollat, që nxënësit duhet të mbajnë uniformën shkollore, e jo t’u lihet shkollave apo drejtorëve të vendosin a donë për ta bartur apo nuk donë. Edhe këtu kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, te obligimet e personelit administrativ dhe ndihmës, neni 8, numër 1.13, roja e natës, cilat shkolla duhet të kenë rojet e natës, sepse jemi dëshmitarë që në mungesë të rojave natës disa shkolla na janë dëmtuar në keqbërësit. Nuk jam i qartë, cilat shkolla duhet t’i kenë rojat e natës?”-pyet anëtari Gashi.

Fadil Gashi, tha se është vullneti që kjo rregullore të plotësohet. Fjala “rregullore” do të thotë “të rregullohet”. Të kihet për bazë gjithçka që bien ndesh me ligjin nuk është mirë të na kthehet. Ne nuk mund të përcaktohem jashtë ligjit dhe Udhëzimit Administrativ”, theksoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Halil Desku, tha se jam kundër shtyrjes së miratimit të kësaj rregulloreje. “Unë mendoj, tha profesor Desku, që do të kishte qenë mirë për ta ndryshuar, përkatësisht për ta plotësuar komisionin, i cili do të na kishte hartuar një rregullore të finalizuar. Të gjithë ne që jemi mësimmëdhënës të japim kontributin tonë në hartimin e kësaj rregulloreje”, pohoi prof. Desku.

Haxhi Ibishi, tha se mendoj që nënkryetari që vjen prej ekzekutivit do të jenë edhe këta mirëkuptues të këtij zëri që është që vjen nga AK, i cili nuk ka ngjyrim politik, s’ka ngjyrim feta edhe s’ka as ngjyrim klanor, se vetë debati po dëshmon se nuk e ka atë ngjyrim, por ka një synim, përpunimin e një rregulloreje të zbatueshme, të përgjegjshme sa më shumë efikase “Jam i vetëdijshëm që Zyra ligjore ka bërë një punë shumë voluminoze, shumë të madhe. Propozimi që të shtohet numri i anëtarëve të komisionit është i qëndrueshëm”, shtoi Kryesuesi Ibishi.

Tunë Dedaj, tha që propozoj të shtyhet, por jo të votohet.

Enver Berisha, tha se nuk shoh asnjë arsye që të shpejtojmë, kemi një rregullore që është në fuqi. “Kërkoj një mobilizim që kjo rregullore të jetë funksionale. Në KPF të shteren të gjitha, në mënyrë që ta kemi një rregullore që do t’i plotësonte të gjitha kriteret. Prandaj, mendoj që në seancën e radhës të miratohet. Shtyrja ka rëndësinë e vet”, shtoi ndër të tjera nënkryetari Berisha.

Ali Shala, tha se kam propozim konkret: të caktohet një grup dhe të punojnë në hartimin e kësaj rregulloreje. Në seancën e radhës të jetë teksti i spastruar. Profesionalizmi të vijë në shprehje”, konstatoi zyrtari Shala.

Halil Desku, tha se ta kemi një komision shtesë nga njerëz profesionalistë, si prof. Ndou, Rasimi, për arsimin e mesëm, ndërsa Marija për arsimin fillor etj.

Kryesuesi Ibishi, vuri në miratim formimin e komisionit për hartimin e rregullores.

Me vota unanime u miratua propozimi për formimin e komisionit.

Fadil Gashi, tha se në KPF nuk ka nevojë që të vijë rregullorja për shqyrtim.

Haxhi Ibishi, kërkoj që të formohet çelësi prej 5 anëtarëve.

U propozua komisioni nga këta 5 anëtarë:

1. Ndue Shabanaj
2. Arben Limani
3. Halil Desku
4. Arben Limani
5. Skënder Maxharaj
6. Avni Gashi

Kryesuesi vuri grupin profesionist në votim.

Me vota unanime u miratua grupi i profesionistëve për hartimin e rregullores.

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015-2022 (ref. Zyrt. i MM),

Kryesuesi foli rreth pikës së rendit të ditës. Fjalën e barti te zyrtari i Drejtorisë së Urbanizmit, z. Dardan Gashi.

Dardan Gashi (zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit) raportoi rreth Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë 2015-2022.

“Është obligim ligjor për autoritetet Komunale. Ky plan duhet te revidohet çdo vit duke u plotësuar me të dhëna të reja duke iu përshtatur nevojave dhe rrethanave aktuale. Për të arritur caqet drejt eficiencës së energjisë ekipi komunal duhet të raportojë çdo 3 muaj në lidhje me energjinë, kursimet dhe rekomandimet drejt autoriteteve komunale. Komuna në një periudhë

afatshkurtër duhet të kontaktojë auditorë të licencuar të energjisë për auditimet e energjisë. Objektivat e përgjithshme të PKEE-së janë reduktimi i konsumit të energjisë, reduktimi i kostove të shpenzimeve të energjisë drejt shkarkimi të buxhetit komunal dhe rinovimi i sistemit të energjisë dhe ndërtesave, ngritjen e vetëdijes për kursimin e energjisë. Izolimi termik i mureve të jashtme, izolimi i pullazit, zëvendësimi i dritareve me xham të dyfishtë, zëvendësimi i sistemit të furnizimit me ngrohje, aplikimi i sistemit eficient dhe aplikimi i pajisjeve shtëpiake eficiente. Prandaj ju rekomandojmë që ky plan hidhet për miratim dhe pas miratimit të këtij plani t'i hapet rrugë investimeve të ndryshme në këtë lëmi”, theksoi zyrtari Bashota.

Rasim Millaku, tha se rëndësia e këtij plani është i pakrahasueshëm, thjeshtë në përpilimin e planit shoh që është bërë një punë e madhe edhe nga një trupë e cila ka pasur detyra tjera, konsideroj që kjo është një ngarkesë që i është bërë këtij grupi. Ka një shpërputhje të madhe në legjenda këtu, diku thuhet “figura” diku “tabelarë”, ata tabelarë ose figura që janë të prezantuara në agjendë nuk gjenden këtu. Ka tabelarë të prezantuar në material, ka një shpërputhje shumë të madhe rreth tekstit dhe kisha dashur një pyetje në fund të këtij materiali: jepet një logo të cilën nuk po e kuptoj çka është kjo, edhe materiali si material është i mirë, mirëpo mungesa e një zyrtari në drejtorinë përkatëse, kisha për të thënë se do të ishte e domosdoshme për t'u plotësuar me një zyrtar sidomos të një lëmie kaq të rëndësishme për shkak se Dardani nuk ka mundësi ta kryejë këtë punë se ka edhe një punë tjetër dhe nuk di që edhe më këtë sa mund t'ia dal”, shtoi ndër të tjera anëtari Millaku.

Ndue Shabanaj, foli rreth plani Komunal për Eficiencë të Energjisë. Anëtari Shabanaj tha se në këtë plan ka një s'përputhje që për bindjen time flet për shpenzime enorme në arsim, shëndetësi, në ofiqarit dhe segmentet të tjera. Këtu vërehet një dallim i madh në mes institucioneve ku shpenzohet, por edhe të atyre që më shumë kursehet. Vërehet një shpërputhje e madhe kryesisht nëpër shkollat tona, ku diku shpenzohet më të madhe, ndërsa diku kursehet maksimalisht. Në këtë aspekt ka dallime të mëdha që s'di për t'i arsyetuar para vetes. Kam një preokupim që me këtë çështje ishte dashur të merret edhe pushteti lokal, edhe Asambleja Komunale, pra, konsideroj që ka nevojë që edhe pushteti lokal të ndërhyjë në përmirësimin e gjendjes në këtë lëmi”, konstatoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

Dardan Bashota, dha sqarime rreth interesimeve të anëtarë të KK-së. “Ne i kemi marrë të dhënat nga shkollat, edhe për objektet e shëndetësisë ne të dhënat i kemi marrë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale”, sqaroi zyrtari Bashota.

Rasim Milaku, tha se ka shpërputhje në legjenda, 70 për qind nuk figurojnë legjendat. Ne nuk kemi as minimumin e standardit në terren. Ka shpërputhje të madhe në përpilim të tekstit”, u shpreh ndër të tjera anëtari Millaku.

Enver Berisha, nënkryetar i Komunës, tha se në shumë sektorë të drejtorive komunale mungojnë zyrtarë konkretë dhe ne po detyrohemi për t'i angazhuar me punë shtesë zyrtarët

aktualë, mirëpo linjat buxhetore po diktojnë pranimin e punëtorëve të rinj, të cilët do t'i kishin kryer punët në aspektin profesional.

“Lidhur me planin në fjalë, ne do të humbim kohë po që se nuk e miratojmë, sepse këtë plan do të na kërkojnë donatorët e jashtëm, prandaj të kemi mirëkuptim. Nëse ka vërejtje konkrete të prezantohen, pastaj mund të inkorporohen në këtë plan”, pohoi ndër të tjera nënkryetari Berisha.

Kryesuesi Ibishi vuri në miratim Planin Komunal të Eficiencës së Energjisë 2016-2012.

Me 23 vota për, me vërejtjet u miratua Plani Komunal i Eficiencës së Energjisë 2016-2022.

Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës.

Kryesuesi Ibishi foli rreth pikës në rend të ditës. Fjalën e barti te drejtori i DKA-së, prof. Hajdin Morina.

Hajdin Morina, drejtor i DKA-së foli rreth çështjes në shqyrtim. Në vazhdim drejtori Morina tha se ka qenë një interesim i jashtëzakonshëm nga ana e prindërve të studentëve, nga vetë studentët dhe të tjerë, në mënyrë që Komuna t'i shikojë mundësitë për ndarjen e bursave për studentë të komunës sonë. “Është një iniciativë, vendos Kryetari, KK-ja, është iniciativë e Kryetarit të Komunës Sokol Bashota, që nga subvencionet Komuna e Klinë të ndaj 20 bursa për studentë të Komunës së Klinës. Kriteret janë ligjore. Në emër të DKA-së e mbështes këtë iniciativë, që bursat të ndahen për studentë me kushte minimale”, shtoi drejtori i DKA-së, prof. Morina.

Tunë Dedaj, theksoi që në emër të Grupit të anëtarëve të AAK-së propozojmë që ky numër prej 20 bursave të rritet në 30. “Po ashtu, shtoi Dedaj, si kriter të merret nota mesatare e jo gjendja ekonomike. Në kushte të barabarta të merret në konsideratë nota mesatare”, shtoi anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, theksoi se e para lidhur me këtë çështje është anashkaluar KPF-ja. “Tre vjet në pushtetin e LDK-së bursat për studentë janë dhënë. Ka qenë kriter nota dhe drejtimet deficitare.. Po ashtu çdo vit janë ndryshuar kriteret. Është e pakuptueshme çfarë po votojmë. Nuk shkohet përmendsh, të shkruhet” shtoi ndër të tjera anëtari Gashi, i cili në vazhdim foli edhe për shumë çështje tjera tematike.

Hajdin Morina, sqaroi iniciativën e Kryetarit dhe të DKA-së për ndarjen e 20 bursave nga subvencionet. Profesor Morina po ashtu foli edhe rreth kriterëve që duhet të merren në konsideratë në ndarjen e këtyre bursave. Në fund drejtori i DKA-së, prof. Morina kërkoi që të formohet një komision rreth kësaj çështjeje.

Marije Selmanaj, foli rreth çështje në shqyrtim. “Të shkohet në formën qysh duhet të mos ketë manipulime. Të shihet kush ka më së shumti nevojë. Fëmijët pa prindër të ndihmohen”, pohoi prof. Selmanaj.

Ramush Agushi, tha se a ka mundësi të rritet numri? “Të merren parasysh kriteret. Me këtë rast, unë kisha propozuar që fëmijët e familjeve të dëshmorëve të kombit, po ashtu edhe fëmijët e familjeve të varfra të kenë përparësi në ndarjen e bursave”, pohoi anëtari Agushi.

Arben Limani, tha se kisha lutur që të ketë transparencë. Kujtoj që në radhë të parë përparësi t’u jepen studentëve ekselencë, ka drejtime që kemi mungesë të kuadrove. Të ketë transparencë dhe ne të informohemi”, shtoi prof. Limani.

Milorad Shakoviq, theksoi se kjo është një nismë e mirë, investimi në studentë është i mirë. “Mendoj se do të kishte qenë mirë që të mos lihen anësh as studentët të komunitetit serb dhe të përfshihen”, shtoi anëtari Sharkoviq.

Petrit Palushi, tha se kisha propozuar që studentët me profile deficitare të përfshihen. “Të gjithë nuk kemi mundësi t’i stimulojmë dhe t’i paguajmë”, shtoi anëtari Palushi.

Haxhi Ibishi, tha se të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës kushtetuta i barazon. “Jemi duke marrë një vendim të propozimit të Kryetarit për 20 bursa”, tha Kryesuesi.

Enver Berisha, tha se kjo gatishmëri e Kryetarit përshëndetet. “Edhe ne kemi pasur dëshirë të kemi më shumë numër të bursave dhe kjo pjesë ndahet nëpërmjet subvencioneve. Sot si AK ta aprovojme një propozim të Kryetarit për 20 bursa nga subvencionet. Kriteret në seancën e radhës të dihen dhe të miratohen nga ju”, konstatoi ndër të tjera nënkryetari Berisha.

Tunë Dedaj, theksoi se është mirë për ta rritur këtë numër, të votohet dhe t’i përcillet Kryetarit.

Halil Desku, tha se këto janë propozime që ekzekutivi i i propozon. “Silleni rregulloren, ne e shqyrtojmë dhe procedojmë”, shtoi prof. Desku.

Fadil Gashi, tha se të fillojë me 20 bursa, të vinë kriteret. “Kjo nuk është asistencë sociale. Edhe niveli qendror i përcakton kriteret lidhur me bursat”, shtoi anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin e Kryetarit për ndarjen e 20 bursave nga subvencionet.

Me vota unanime u miratua propozimi.

Pika e nëntë: Rishqyrtimi i Vendimit për Planin Rregullues të Hollësishëm për qytetin e Klinës – për harmonizim me Ligjin për Planifikim Hapësinor, Nr. 04/L-174.

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në rend të ditës. “Nga niveli qendror kemi sugjerimin që të hiqet fjala “urban”.

Kryesuesi vuri në miratim që në Planin Rregullues të Hollësishëm për qytetin e Klinës të hiqet fjala “urban”.

Me vota unanime u votua që fjala në Planin Rregullues të Hollësishëm për qytetin e Klinës “urban” të hiqet.

Pika e dhjetë: Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit.

Tunë Dedaj, shqetësimin e adresoj te drejtori përkatës, pse nuk i zbatohet vendimi i qeverisë për pirjen e duhanit? Pastaj, shtoi anëtari Dedaj, shqetësimi i Deiqit dhe Këpuzi për pronat për kishë dhe xhami, pse zvarriten?

Vlora Tafilaj, shtroi interesimin, se a ka ndonjë plan veprimi për qentë endacakë. “Kemi informacione se është lejuar ekzekutimi i tyre për Komunën e Klinës dhe komunat tjera të Kosovës”, shtoi anëtarja Tafilaj.

Gjokë Lleshaj, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente, sqaroi çështje e ngritur nga anëtarja Tafilaj. Drejtori Lleshaj theksoi që së shpejti do të procedojmë me procedurat për zhdukjen e qeneve endacakë. Deri me tash nuk kemi pasur mundësi, ngase nuk na është lejuar ekzekutimi i tyre. Shpejt do të fillojë për t’u zgjedhur ky problem që nuk është vetëm i Komunës së Klinës, por edhe i komunave të tjera të Kosovës”, shtoi drejtori Lleshaj.

Petrit Palushi, tha se me Radio Albën a kemi bërë marrëveshje që ai medium t’i përcjell seancat e Asamblesë Komunale, mbase konsideroj që përcjellja e seancave nga Radio Alba do të ishte mirë për transparencën e qytetarëve”, u shpreh anëtari Palushi.

Enver Berisha, nënkryetar i Komunës, duke iu përgjigjur interesimit të anëtarit Palushi, u shpreh se jemi në bisedime me përfaqësues të këtij mediumi lokal për arritjen e një marrëveshjeje, mirëpo me kushtet që kemi kërkuar nuk kemi mundur të realizojmë marrëveshjen. “Jemi në bisedime”, u shpreh nënkryetari Berisha.

Milorad Sharkoviq, ngriti çështjen e rrethojave të varrezave serbe në Klinës. “Te pusi i Dollcit po vinë shumë njerëz për t’u furnizuar me ujë të pijshëm, mirëpo ata po hedhim mbeturina që ka mundësi që nga ato mbeturina të shfaqet edhe ndonjë epidemi”, shtoi Sharkoviq.

Gjokë Lleshaj (drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente), sqaroi se me kompaninë kemi biseduar dhe ata i kanë hequr ato mbeturina, mirëpo njerëzit ka mundësi t’i vendosin të tjerat mbeturina. Duhet të jetë një vetëdijësim më i madh i qytetarëve. Mbeturinat hedhën kudo. Do të ndërmarrim masa. Për rrethojat nuk kemi buxhet. Kuvendi i komunës me rishikimin e buxhetit do të caktojë një shumë të buxhetit për këtë projekt”, shoi drejtori Lleshaj.


Enver Berisha (nënkryetar i Komunës), tha se aktualisht ndërmarrja “Ambienti” ka shtrirë angazhimin në tërë Komunën e Klinës. “Është komuna që po punon më së shumti në këtë

drejtim. Do t'i shikojmë mundësitë për grumbullimin edhe të mbeturinave të ngurta. Këtë plan mendoj që do ta realizojmë”, theksoi nënkryetari Berisha.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë. Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 13.00 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendi,
Dr. Haxhi IBISHI

